



**QKSUK**

**QENDRA KLINIKE STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS  
STOMATOLOŠKI UNIVERSITETSKI KLINIČKI CENTAR KOSOVA**

**STATUTI  
I  
QENDRËS KLINIKE STOMATOLOGJIKE  
UNIVERSITARE TË KOSOVËS**

**Prishtinë, Prill 2006**

Bazuar në Politikën Shëndetësore të Kosovës, Ligjin për Shëndetësi Nr. 2004/4, posaçërisht nenin 50 të këtij Ligji, Ministria e Shëndetësisë e Kosovës aprovon Statutin e propozuar nga Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës.

## I Dispozitat e përgjithshme

### *Neni 1*

1.1. Me këtë statut rregullohet emërtimi, selia dhe veprimtaria, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e Institucionit, trupat e Institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, aktet e përgjithshme, pronësia dhe financimi, transparenca, konfidenca afariste dhe profesionale, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë të kujdesit shëndetësor në Qendrën Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (tas e tutje Qendra).

1.2. Themelues i Qendrës është Ministria e Shëndetësisë e Kosovës, (në vazhdim të tekstit Ministria).

1.3. Bazuar në dispozitat dhe kushtet e parapara në nenet 40, 41, 42, 43 dhe 73 të Ligjit për Shëndetësi, fillimi i punës së Qendrës bëhet me akt të veçantë nga Ministria.

### *Neni 2*

2.1. Qendra ka statusin e personit juridik publik, me cilësi të autoritetit punëdhënës, ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet kujdesi shëndetësor tretësor dhe aktiviteti arsimor dhe kërkimoro-shkencor.

### *Neni 3*

3.1. Qendra disponon me mjetet dhe pasurinë e cila është pronë e Ministrisë.

3.2. Qendra si institucion shëndetësor terciar është përvetësues i fondeve nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe burimeve tjera të parapara me Ligjet përkatëse.

3.3. Qendra ofron shërbime terciare stomatologjike për tërë popullatën e Kosovës dhe të gjithë pacientëve të referuar në këtë Qendër.

## II Emërtimi dhe selia

### *Neni 4*

- 4.1. Emri i Institucionit është Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës.
- 4.2. Shenja njohëse e Qendrës është me tre ngjyra: kaltër e çeltë, bardhë dhe kaltër e mbyllët, në mes është vizatimi që simbolizon dhëmbin. Nën të mbishkrimi QKSUK, Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës dhe Stomatološki Universitetski Klinički Centar Kosova.
- 4.3. Emërtimi i Qendrës duhet të jetë i mbishkruar në objekt në të cilën kryhet veprimtaria shëndetësore, mësimore dhe shkencore.
- 4.4. Për ndryshimin e emrit dhe selisë së Qendrës vendos themeluesi.

### *Neni 5*

- 5.1. Selia e Qendrës gjendet në adresën “Rrethi i Spitalit” p.n. në Prishtinë.

### *Neni 6*

- 6.1. Qendra posedon vulën që në qarkullimin juridik paraqitet si Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës.
- 6.2. Vula është në formën e rumbullakët me diametër 2.5 cm.
- 6.3. Vula duhet të përmbajë emërtimin e Institucionit, selinë, dhe të jetë në gjuhët zyrtare në përdorim në Kosovë.
- 6.4. Qendra posedon vulën katrore, me dimensione 60 x 30 mm, që përmban emërtimin, selinë, hapësirën për evidentimin e numrit dhe datës së pranimit të dokumentit.
- 6.5. Për numrin e vulave, mënyrën e përdorimit dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtje vendos Drejtori.
- 6.6. Çdo vulë ka numër identifikues.
- 6.7. Çdo mjek duhet të ketë vulën zyrtare, përmbajtja dhe mënyra e përdorimit të jetë në pajtim me Udhëzimin Administrativ (për shëndetësi) 24/2004 mbi Vulat zyrtare e profesionalistit shëndetësor
- 6.8. Dita e QKSUK-se është 24 prilli.

6.9. Dita e QKSUK-së shenohet në mënyrë solemne me dhënjen e shpërblimeve dhe mirënjohjeve për punëtorët e dalluar.

### III Veprimtaria shëndetësore dhe arsimore e Qendrës

#### *Neni 7*

7.1. Qendra është bazë e veprimtarisë shëndetësore dhe asaj arsimore në bashkëpunim me Degën e Stomatologjisë të fakultetit të Mjekësisë.

7.2. Qendra zbaton Kujdesin Shëndetësor sipas Ligjit për Shëndetësi të Kosovës dhe akteve nën ligjore.

7.3 Kujdesi shëndetësor realizohet në Klinikat dhe njësitë përkatëse sipas Nenit 11 të këtij Statuti.

7.4 Organizimi dhe zbatimi i punës profesionale dhe pjesëmarrja në realizimin e programeve të mbrojtjes shëndetësore stomatologjike.

7.5 Organizimi dhe zbatimi i formave të ndryshme të përsosjes profesionale.

7.6 Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në të gjitha aktivitetet e shëndetit oral në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar

7.7 Qendra ofron shërbime stomatologjike të nivelit dytësor për Regjionin e Prishtinës dhe tretësor për tërë popullatën e Kosovës.

7.8 Lista e Shërbimeve që duhet siguruar në Qendër nxirret me akt të veçantë nga Këshilli Drejtues, me propozim të Këshillit Profesional e të aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë.

7.9. Departamenti i shërbimeve profesionale i Qendrës implementon aspektet e cilësisë së shërbimeve.

7.9.1 Departamenti i shërbimeve profesionale i Qendrës siguron dhe zbaton sistemin unik të informimit shëndetësor.

7.9.2 Njësitë Punuese janë të obliguara të mbajnë kartelat shëndetësore dhe të mbajnë bazën e shënimeve shëndetësore.

7.9.3 Departamenti i shërbimeve profesionale i Qendrës do të kërkojë prej Njësive Punuese që t'i përmbahen standardeve themelore për mjetet e punës dhe të materialit përkatës.

## *Neni 8*

Veprimtaria arsimore e Qendrës përbëhet nga:

- a) Organizimi dhe realizimi i programit mësimor për studime themelore Universitare dhe Pasuniversitare të bazuar në planin dhe programin e Fakultetit të Mjekësisë – Dega e Stomatologjisë.
- b) Organizimi dhe realizimi i programit të specializimit në lëmitë e stomatologjisë,
- c) Puna në përshtatjen dhe adaptimin e standardeve evropiane në lëmin e Stomatologjisë.

8.1 Titujt akademik dhe profesional do të njihen me sistematizimin e vendeve të punës në Qendër, dhe njëherësh do të gradohen sipas ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë këtë lëmi.

8.2. Raportet mes Qendrës dhe Degës së Stomatologjisë të Fakultetit të Mjekësisë rregullohen me një memorandum të mrëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

## IV Statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi

### *Neni 9*

9.1. Qendra është Institucion i cili duhet të evidentohet në regjistrin pranë Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë.

9.2. Qendra kryen dhe ofron shërbime të kujdesit shëndetësor për qytetarët e Kosovës sipas parimeve të përcaktuara në Ligjin për Shëndetësi Neni 12, Ligjin për Planin e Institucioneve Shëndetësore, me këtë Statut dhe dispozitave tjera Ligjore.

9.3. Për nënshkrimin e Kontratave me të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten patundshmëritë e Qendrës dhe degëve të saja Qendra duhet të ketë së pari aprovimin e Ministrisë.

9.4. Në rast të nënshkrimit të Kontratave nga paragrafi 9.3. Qendra paraqitet si subjekt i pavarur juridik dhe afarist, bazuar në Ligjin për Prokurim Publik dhe Ligjeve të nxjerra nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

9.5. Për përgjegjësitë e mara financiare Qendra përgjigjet me tërë pasurinë e saj.

9.6. Themeluesi i Qendrës përgjigjet në mënyrë solidare për obligimet e saja.

9.7. Qarkullimi i mjeteve financiare bëhet përmes xhirollogarisë unike të Qendrës pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Kosovës.

#### *Neni 10*

10.1 Drejtori i Qendrës ka të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist, brenda veprimtarisë së Qendrës, duke marrë parasysh përkufizimet e këtij Statuti.

### V Organizimi i Qendrës

#### *Neni 11*

11.1. Qendra për ta realizuar funksionin e mbrojtjes shëndetësore për qytetarët e vet është e organizuar në këto Departamente, Klinika dhe Njësi:

11.2. Departamenti i Administratës, i cili përbëhet nga:

- Njësia e personelit
- Njësia për shërbime juridike
- Njësia për buxhet dhe financa
- Njësia për prokurim

Departamenti i Administratës është përgjegjës për çështjet administrative dhe teknike në lidhje me:

- i. Administrimin e personelit;
- ii. Aspektet ligjore;
- iii. Kontabilitetin dhe financat;
- iv. Mirëmbajtjen dhe dokumentimin e pronës;
- v. Dosjet;
- vi. Qarkullimin e mallrave;
- vii. Përgatitë dhe mbanë procedurat, në përputhje me Ligjet dhe udhërrëfyesit e Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave;
- viii. Ofron sigurimin e zhvillimit të investimeve kapitale dhe të ardhurave, duke u siguruar se këto plane janë të bazuara në resurset që mund të jenë në dispozicion të Qendrës;
- ix. Aspektet tjera të përgjithshme të administratës së Qendrës.

11.3.. Departamenti i shërbimeve profesionale

Në kuadër të Departamentit të shërbimeve profesionale ekzistojnë këto njësi organizative:

1. Klinika e Sëmundjeve të Dhëmbit me Endodoncion;
2. Klinika e Parodontologjisë dhe Mjekësisë Orale;
3. Klinika e Pedodoncisë dhe Stomatologjisë Preventive;

4. Klinika e Ortopedisë së Nofullave;
5. Klinika e Protetikës Stomatologjike;
6. Klinika e Kirurgjisë Orale;
7. Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale;
8. Laboratoriumi i Teknikës së Dhëmbëve;
9. Paraklinika Stomatologjike me Rentgen diagnostikën.

11.4. Me qëllim të sigurimit të kujdesit të integruar shëndetësor nga fusha e Kirurgjisë Maksillofaciale si dhe me qëllim të zbatimit të detyrave me rëndësi të veçantë nga kjo lëmi, Qendra do të fillon aktivitetet e saja të koordinuara me Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe Ministrinë për transferimin e Klinikës së Kirurgjisë Maksillofaciale në kuadër të Qendrës së Klinikës Universitare të Kosovës.

Departamenti i shërbimeve profesionale i Qendrës është përgjegjës për çështjet profesionale-shëndetësore në lidhje me:

- a) Organizimin dhe udhëheqjen e punëve profesionale në shërbimet klinike të Qendrës;
- b) Organizimin dhe harmonizimin e punëve të punëtorëve shëndetësor sipas njësive organizative;
- c) Siguron standardet më të larta për kujdesin e pacientëve;
- d) Udhëheqë zhvillimin e strategjisë të shërbimeve stomatologjike në kuadër të strategjisë së përgjithshme shëndetësore të Kosovës;
- e) Siguron efektivitetin e shërbimeve stomatologjike me kualitet të lartë;
- f) Siguron kujdesin shëndetësor stomatologjik për të gjithë popullatën pavarësisht nga gjinia apo përkatësia etnike;
- g) Përkrah dhe zbaton normat në lëminë e shëndetit oral të përpiluara nga MSH;
- h) Ndhmon dhe koordinon bashkëpunimin efektiv ndërmjet shërbimeve stomatologjike;
- i) Ndhmon dhe zhvillon sistemin e informimit shëndetësor në kuadër të shërbimeve stomatologjike;
- j) Është përgjegjës për implementimin e masave të një niveli të duhur për parandalimin e infeksionit të kryqëzuar.

11.4. Qendra zbaton sistemin unik të informimit shëndetësor ashtu siç është paraparë me Ligjin e Shëndetësisë dhe aktet nën ligjore që rregullojnë këtë lëmi.

## VI Udhëheqja dhe Trupat e Qendrës

### Këshilli Drejtues

#### *Neni 12*

12.1. Këshilli Drejtues udhëheq me tërë aktivitet e Qendrës.

#### *Neni 13*

13.1. Këshilli Drejtues ka pesë (5) anëtarë,

- a. Drejtori Ekzekutiv i Qendrës, Kryeson Këshillin,
- b. Zëvendës Drejtori
- c. Kryeshefi i Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore të Qendrës
- d. Kryeshefi i Departamentit të Administratës të Qendrës
- e. Kryenifermierja e Qendrës

13.2. Mandati i anëtarëve të këshillit është tre (3) vjet. Ky mandat mund të përfundoj më parë se tre vjet në rast:

- i. Të dorëheqjes së anëtarit të Këshilli Drejtues,
- ii. Nëse marrin pjesë në marrjen e vendimeve joligjore ose vendimeve të cilat i shkaktojnë dëm Qendrës
- iii. Nëse tregon mosrespektim ndaj obligimeve të punës,
- iv. Në rast të ndërprerjes së marrëdhënies se punës në Qendër.

#### *Neni 14*

14.1. Në punët e Këshillit Drejtues sipas nevojës me autorizim të Këshillit Drejtues mund të marrin pjesë edhe udhëheqësat e njësive sipas nënit 11 të këtij Statuti.

#### *Neni 15*

15.1. Këshilli Drejtues kryen këto punë të parapara me këtë Statut dhe vendos për:

1. Veprimtarinë e Qendrës dhe vërteton politikën punuese të Qendrës,
2. Propozon statutin e Qendrës,
3. Aprovon raportin e punës dhe llogaritë vjetore të Qendrës dhe raporton Ministrisë përmes Sekretarit të përhershëm,
4. Vendos për shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të ligjit,
5. Bien programin e punës dhe planin financiar,
6. Bie rregullore për organizimin e Qendrës dhe akte tjera në përputhshmëri me ligjin dhe këtë Statut,



7. Aprovon çmimet e shërbimeve shëndetësore dhe të tjera të cilat i ofron Qendra e të cilat nuk janë të aprovuara nga ana e Ministrisë,
8. Bien planin e furnizimit të Qendrës dhe vendos për: dhënien në shfrytëzim të lokaleve dhe mjeteve, furnizimin dhe dhënjen në shfrytëzim të mjeteve të veçanta, pas marjes së pëlqimit nga Ministria,
9. Bien planin mbi Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional të kuadrit medicinal dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor dhe siguron aplikimin e tij,
10. Bien planin dhe programin e masave për mbrojtje në punë.
11. Siguron mbarëvajtjen e punëve,
12. Emëron komisione të përkohshme dhe organe tjera punuese,
13. Vendos për sigurimin e pasurisë së Qendrës dhe të punëtorëve në bazë të ligjit,
14. Propozon ndërtimin dhe adoptimin e objekteve, si dhe për burimet e mjeteve për kryerjen e këtyre punimeve duke u bazuar në pëlqimin e themeluesit,
15. Shqyrton raportet periodike mbi punën profesionale,
16. Kryen edhe punë të tjera të cilat i janë lënë në kompetencë, me këtë statut dhe akte tjera normative të Qendrës.

#### *Neni 16*

- 16.1. Këshilli Drejtues i Qendrës i kryen detyrat brenda përgjegjësisë së veta në mbledhje.
- 16.2. Këshilli Drejtues merr vendim kur janë prezent me tepër se gjysma e anëtarëve.
- 16.3. Këshilli Drejtues merr vendim me shumicë të votave të anëtarëve prezent.
- 16.4. Në mbledhjen e Këshillit Drejtues mbahet procesverbali të cilin e aprovojnë pjesëmarrësit në mbledhjen vijuese.
- 16.5. Këshilli Drejtues bjen rregulloren e punës të Qendrës në të cilën rregullohen më detajisht çështjet në lëmin e punës të cilat nuk janë të rregulluara me ligj dhe këtë statut.

#### *Neni 17*

- 17.1. Struktura organizative e Qendrës bazohet në Organogramin e saj të nxjerr nga Këshilli Drejtues dhe i aprovuar nga Ministria

#### *Neni 18*

- 18.1. Drejtori është përgjegjës për afarizmin, prezanton dhe përfaqëson Qendrën dhe është përgjegjës për ligjshmërinë në punë.

18.2. Drejtori udhëheq punën profesionale të Qendrës në bashkëpunim me Këshillin Drejtues, Këshillin Profesional dhe sipas nevojës me Kolegjiomet profesionale të njësive organizative të nenit 11 të këtij statuti.

#### *Neni 19*

19.1. Qendrën e udhëheq drejtori i Qendrës.

19.2. Drejtorin e Qendrës e zgjedh dhe e shkarkon Ministria e Shëndetësisë në pajtim të Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36, mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe të Urdhëresës Administrative 2003/2 për implementimin e kësaj Rregulloreje, dhe dispozitave të parapara me këtë Statut.

19.3. Drejtori i Qendrës mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet e përgjithshme të punësimit në shërbimin civil dhe duhet të jetë:

Stomatolog Specialist në njërin nga degët e Stomatologjisë;

Mjek Specialist në njërin nga degët e Mjekësisë;

Të ketë së paku shtatë (7) vjetë përvojë në Sistem Shëndetësor, prej tyre tre (3) në poste udhëheqëse;

Të ketë së paku thirrjen arsimore të doktorit të shkencave mjekësore, kualifikimi superior nga Menaxhmenti shëndetësor do të jenë përparësi.

#### *Neni 20*

20.1. Vendimin për shpalljen e konkursit për drejtor të Qendrës e merr themeluesi bazuar në nenin 13.2 të Statutit të QKSUK-ës.

20.2. Në mungesë të drejtorit QKSUK-së dhe me autorizim të tij në raste tjera me Qendrën udhëheq Zëvendës drejtori.

#### *Neni 21*

21.1. Drejtori i Qendrës është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë dhe afarizmin e Qendrës, si dhe për punën profesionale në Qendër, e cila duhet të organizohet dhe udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe akteve tjera të përgjithshme ligjore.

21.2 Drejtori është përgjegjës për përkujdesjen eficiente dhe efektive të shërbimeve shëndetësore për gjithë popullatën sipas Nenit 3.3. dhe përgjigjet për detyrat që vijojnë:

- Në pajtim me Politikën Shëndetësore dhe Ligjin për Shëndetësi të Kosovës, drejtori i Qendrës i propozon për miratim Ministrisë, Planin e Punës dhe Buxhetin e Qendrës për vitin vijues.

- Nën mbikëqyrjen dhe autorizimin e Sekretarit të përhershëm zbaton buxhetin e Qendrës.
- Të jetë përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në Qendër.
- Të zhvilloj marrëdhënie të mira me donatorët, dhe OJQ-të, dhe me partnerët për zbatimin e tyre.
- Të mundësojë zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të Qendrës.
- Të vendos mekanizma të sigurimit të cilësisë në objektet e Qendrës.
- Të jap kontribut për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të Qendrës.
- Ta avancojë punën ekipore.
- Kryen punët tjera sipas ligjit dhe akteve të përgjithshme të Qendrës.

21.3. Programi i punës i Qendrës realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të sistemit shëndetësor të nxjerra nga Ministria.

21.4. Në programin vjetor të punës duhet të përcaktohen:

masat, aktivitetet, dhe rezultatet e pritura të kujdesit shëndetësor në Qendër

- plani vjetor i punës
- organizimi dhe udhëheqja
- burimet njerëzore
- plani financiar
- raportet mujore, vjetore të punës dhe raportet financiare.

21.5. Për kryerjen e punëve të tij drejtori i Qendrës i përgjigjet Ministrisë përmes Sekretarit të përhershëm.

21.6. Procedurën për ndërmarrjen masave administrative ndaj drejtorit të Qendrës, suspendim apo masa të tjera deri në shkarkim, mund t'i inicojë Këshilli Mbikqyrës i autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë kur konstatohen shkelja e procedurave siq janë:

- i. Sigurimi i kujdesit shëndetësor qytetarëve të Kosovës, sipas Ligjit për Shëndetësi, dhe Akteve tjera nën ligjore;
- ii. Sigurimi i minimumit të kujdesit shëndetësor gjatë grevës;
- iii. Ushtrimi i veprimtarisë shëndetësore në Qendër, pa plotësuar kushtet për fillimin e punës në institucionin shëndetësor sipas Ligjit të shëndetësisë;
- iv. Sigurimi i evidencave dhe dokumentacionit tjetër mjekësor, si dhe nuk siguron përcjelljen e të dhënave të parapara me Ligj;
- v. Harmonizimi dhe organizimi i akteve normative sipas Ligjit të Shëndetësisë dhe këtij Statuti;

## *Neni 22*

22.1. Drejtori ka për detyrë që gjatë punës dhe vendimeve të Këshillit Drejtues që të tërheq vëmendjen:

- Në aktet e propozuara që janë në kundërshtim me ligjet relevante gjegjësisht aktet e përgjithshme të Qendrës,
- Që akti i propozuar është në kundërshtim me programin e punës së Qendrës,
- Që akti i propozuar nuk i kontribuon qëllimit.

## **Trupat e Qendrës**

### *Neni 23*

23.1. Për përmbushjen e detyrave të veçanta, Këshilli Drejtues i Qendrës formon Trupa profesionale pranë Qendrës, siç janë:

Këshilli profesional,  
 Kolegji profesional  
 Komisioni disiplinor  
 Komisioni për ankesa  
 Komiteti për Kontroll të Cilësisë  
 Komiteti për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional  
 Komisioni Etik-Profesional, etj.

23.2. Anëtarët e trupave profesionale emërohen nga drejtori.

23.3. Këshilli Drejtues përmes drejtorit të Qendrës sipas nevojës mund të formojë edhe trupa tjerë profesionale pranë Qendrës.

## **Këshilli Profesional**

### *Neni 24*

24.1 Këshilli Profesional është trup këshillëdhënës për Këshillin Drejtues të Qendrës.

24.2. Këshilli Profesional e përbëjnë :

- Kryeshefat e Departamenteve dhe Shefat e Klinikave nga neni 11 i këtij Statuti
- Kryeinfermieret/ët e Departamenteve dhe Klinikave nga neni 11 i këtij Statuti

24.3. Këshillin profesional e udhëheq drejtori ekzekutiv

24.4. Këshilli profesional e bien rregulloren e punës për punën e Këshillit.

#### *Neni 25*

25.1. Këshilli Profesional i kryen këto punë:

- i. përgatitë thërret dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit Profesional
- ii. e verifikon rendin e ditës së mbledhjeve
- iii. siguron mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.

#### *Neni 26*

26.1. Këshilli Profesional i Qendrës përveç detyrave të parapara me ligj i kryen edhe këto detyra:

- Propozon Këshillit Drejtues marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë,
- Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme lidhur me punën e punëtorëve shëndetësor si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale,
- Shqyrton nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe propozon Këshillit drejtues dërgimin e punëtorëve shëndetësor në përsosje profesionale dhe shkencore,
- Shqyrton dhe vendos lidhur me çështjet e ndryshme të cilat Këshilli Drejtues ia parashtron Këshillit Profesional.

### **Kolegji profesional**

#### *Neni 27*

27.1. Me qëllim të shqyrtimit të çështjeve në lëmin e punës profesionale në çdo Klinikë nga neni 11 i këtij Statuti themelohet Kolegji Profesional.

27.2. Kolegjin profesional e përbëjnë:

- Shefi i Klinikës sipas nenit 11 të këtij Statuti
- Infermierja mbikqyrse sipas nenit 11 të këtij Statuti
- Punëtorët profesional të Klinikës sipas nenit 11 të këtij Statuti

27.3 Kolegji profesional i kryen këto punë:

- Shqyrton çështjet lidhur me udhëheqjen e punës profesionale në Klinikën përkatëse, merr qëndrim dhe propozim lidhur me zgjidhjen e këtyre çështjeve,
- Shqyrton dhe përmes Kryeshefit të Departamentit propozon Këshillit Profesional, për nevojën dhe arsyet profesionale të implementimit të metodave të reja diagnostifikuese dhe terapeutike
- Propozon Këshillit Profesional dhe drejtorit për marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë.

27.4. Shefi i Klinikës sipas nenit 11 të këtij Statuti është edhe kryetar i kolegjit profesional.

## **Këshilli etik**

### *Neni 28*

28.1. Këshilli etik është trup i cili siguron kryerjen e veprimtarisë së Qendrës mbi bazat e etikës dhe deontologjisë.

28.2. Anëtarët e këshillit etik i emëron Këshilli Drejtues.

28.3. Këshilli etik përbëhet nga 5 anëtarë:

- Katër (4) përfaqësues të Qendrës (3 nga profesioni mjekësor dhe një nga profesioni jo mjekësor)
- Një person i cili është i profesionit jo mjekësor nga Kryqi i Kuq i Kosovës i/e cili/a është individ i/e spikatur për punën shkencore ose shoqërore.

### *Neni 29*

29.1. Këshilli etik i Qendrës i kryen këto punë:

- Përcjell implementimin e veprimtarive etike dhe deontologjike në lëminë e shëndetësisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë në Qendër.
- Miraton kërkime shkencore në Qendër sipas dispozitave Ligjore që rregullojnë këtë lëmi.
- Shqyrton dhe çështje të tjera etike lidhur me veprimtarinë e Qendrës.

29.2. Këshilli etik bien rregulloren e punës të Këshillit.

29.3. Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave tjera përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra nga Këshilli Drejtues i Qendrës, nëse ato nuk janë të përcaktuara me akte të tjera nga Ministria e Shëndetësisë

## **Organizimi sindikal**

### *Neni 30*

30.1. Në Qendër mund të organizohet Organizata sindikale ku punëtorët me anëtarësimin e tyre vullnetar do t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e veta të garantuara me konventat ndërkombëtare të punës.

30.2. Në rast greve të punëtorëve, në Qendër duhet të sigurohet minimumi i kryerjes së detyrave të punës apo shërbimeve sipas Ligjit për Shëndetësi.

## VII Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

### *Neni 31*

31.1. Në kuadër të Qendrës organizohet Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional i të gjithë punëtorëve shëndetësor, bazuar në dispozitat e Ligjit për shëndetësi, akteve tjera nën ligjorë që rregullojnë këtë lëmi dhe këtij Statuti.

31.2. Ministria bazuar në Udhëzimet administrative 23/2004 Zhvillimi i vazhdueshëm profesional, 17/2003 Edukimi specialistik pas-diplomik, 16/2003, Edukimi themelor profesional dhe provimi i licencës për punëtorët shëndetësorë, 15/2001 Edukimi i vazhdueshëm profesional, me propozim të Komiteteve specialistike në lëmitë përkatëse emëron Mentorët klinik në Qendër.

## VIII Mbikëqyrja e Qendrës

### *Neni 32*

32.1. Mbikëqyrjen e Qendrës e bënë Këshilli Mbikëqyrës i Qendrës.

32.2. Formimi, përbërja dhe funksionimi i Këshillit Mbikëqyrës përcaktohet me Udhëzim Administrativ të nxjerrë nga Ministria.

32.3. Mbikëqyrja e brendshme e punës profesionale kryhet në mënyrën e paraparë me rregulloren mbi mbikëqyrjen e brendshme;

## IX Aktet e përgjithshme

### *Neni 33*

33.1. Aktet e përgjithshme të Qendrës janë: Statuti, rregulloret e punës dhe vendimet përmes të cilave rregullohen çështjet nga veprimtaria e Institucionit.

### *Neni 34*

35.1 Me propozim të drejtorit, Këshilli Drejtues nxjerr këto akte të përgjithshme të Qendrës.

1. Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
2. Rregulloren për punë;

3. Rregulloren për gradim, pagesa dhe të drejta tjera materiale të punëtorëve nëse me akte tjera nuk është rregulluar ndryshe;
4. Rregulloren për mbrojtjen në punë;
5. Rregulloren për mbrojtje kundër zjarrit;
6. Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm;
7. Rregulloren për rendin shtëpiak;
8. Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme;
9. Rregulloren për parandalimin e infeksioneve;
10. Rregullore tjera për mbarëvajtjen e punës në Qendër.

## X Pronësia, Buxheti dhe Financat

### **Pronësia**

#### *Neni 35*

35.1. Pasurinë e Qendrës e përbëjnë të drejtat dhe të mirat materiale, të cilat kanë qenë të evidentuara si pronë shoqërore, me të cilat Qendra ka pas të drejtë të disponojë në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës.

35.2. Po ashtu pasurinë e Qendrës e përbëjnë të drejtat dhe të mirat materiale, të cilat pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, Qendra i ka fituar me punë, ose nga të hyra të tjera.

### **Buxheti**

#### *Neni 36*

36.1 Çështjet buxhetore dhe financiare të Qendrës administrohen në mënyrë transparente në pajtim me rregulloret mbi përdorimin e fondeve nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës si dhe me të gjitha procedurat, në përputhje me udhëzuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

36.2 Buxheti dhe llogaritë e Qendrës duhet të përfshijnë tërë shpenzimet operative të Njësive punuese.

36.3. Prokurimi nga Qendra bëhet konform rregullave të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës.

36.4. Qendra ia prezanton buxhetin vjetor Ministrisë për miratim.



36.5. Drejtori mund të kërkojë Revizion të jashtëm që të monitorojë shfrytëzimin e drejtë të mjeteve.

## **Financimi**

### *Neni 37*

37.1. Qendra shfrytëzon burimet financiare konform Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, dhe burimet tjera të parapara me Ligjet përkatëse.

37.2. Bashkëpagesa për shërbimet e ofruara në Qendër, si burim i financimit të aktiviteteve të Qendrës, do të bëhet në bazë të çmimoreve së aprovuar nga Ministria.

37.3. Qendra do të nxjerr akte të veçanta të detajizuara për llojin dhe shumën e pagesave të ndryshme që do të jetë në pajtim me rregulloret përkatëse të nxjerra nga Ministria.

## **XI Transparenca në punë**

### *Neni 38*

38.1. Struktura, kushtet si dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në kuadër të veprimtarisë së Qendrës janë publike dhe transparente ndaj personave juridik, fizik, përveç kur bëhet fjalë për sekret afarist dhe profesional.

### *Neni 39*

39.1. Informatat dhe të dhënat mbi veprimtarinë si dhe shikimi në dokumentacionin mbi veprimtarinë shëndetësore, personave të autorizuar apo mjeteve të informimit mund të iu jep vetëm drejtori ose punëtori i Qendrës të cilin ai e autorizon.

## **XII Konfidenca profesionale**

### **Sekreti afarist dhe profesional**

#### *Neni 40*

40.1 Zbulim i sekretit afarist konsiderohet dhënia e dokumentacionit dhe të dhënave të tjera në shikim personave të paautorizuar, veprimi i cili do të shkaktonte dëm reputacionit dhe interesit afarist të Qendrës;

#### *Neni 41*

41.1. Sekret afarist konsiderohen:

- i. Dokumentet të cilat drejtori i vlerëson si sekret afarist;

- ii. Të dhënat të cilat organi kompetent i konsideron sekrete dhe ia ofron Institucionit si të tillë;
- iii. Masat dhe mënyra e veprimit në raste të krijimit të situatave të jashtëzakonshme.
- iv. Dokumentacionin që përmban planin e mbrojtjes fiziko-teknike të punëtorëve dhe pasurisë së Institucionit;
- v. Si dhe të dhëna të tjera, publikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e Institucionit dhe themeluesit të tij.

*Neni 42*

42.1. Mos ruajtja e sekretit afarist konsiderohet si shkelje e rëndë e detyrave të punës.

42.2. Për ruajtjen e sekretit afarist drejtpërsëdrejti kujdeset drejtori.

### XIII Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

*Neni 43*

43.1. Aktet e përgjithshme nga Neni 33 dhe 34 i këtij Statuti do të konsolidohen në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij statuti.

*Neni 44*

44.1. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti përfundon fuqia e akteve tjera që rregullojnë punën e Qendrës, e që janë në kundërshtim me këtë Statut.

*Neni 45*

45.1. Ky Statut hyn në fuqi, pas aprovimit nga Ministria.

Me datë 03.04.2006

Ministria e Shëndetësisë aprovon këtë Statut.

Sadik Idrizi  
Ministër i Shëndetësisë

